

Data 02.10.2024

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS:**

*Gaz i lengshëm*

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

*Gaz i lengshem propan- Kodi – 09122110-4*

**VLERA E FONDIT LIMIT:**

*8.924.007 (tetë milion e nëntëqind e njëzet e katër mijë e shtatë) lek pa tvsh*

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

*a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8.*

*b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP i ndryshuar, nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

**2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.2.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim nga Administrata Tatimore/Vërtetim të gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik për xhiron mesatare vjetore të realizuar gjatë tre viteve të fundit financiare, nga data e zhvillimit të procedurës në vlerën prej jo më pak se 40% të fondit limit i vënë në dispozicion. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale, në të paktën një Vit të periudhës së kërkuar. Si provë për plotësimin e këtij kriteri kualifikues, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë vërtetim nga Administrata Tatimore ku të tregohet xhiroja vjetore për vitet e sipërpermendura.

*Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".*

*Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklarave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike". Në përcaktimin e vlerës së xhiros autoriteti kontraktor është referuar në pikën 2, gërma (c) të Nenit 43, Seksioni III të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".*

## 2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi nga operatori ekonomik për furnizime të mëparshme të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se 40% të fondit limit/vlera e pritshme të MK, **për të cilën konkurren operatori dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.**

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara, ose
- b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

*Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më të vogël se 40% të fondit limit/vlera e pritshme të MK, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.*

*Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:*

*Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më të vogël se 40% të fondit limit/vlera e pritshme të MK, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin 40, pika 4 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar.*

2.3.2.Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë Licencën e Tregëtimit të Karburanteve, sipas përcaktimeve të germës ç, neni 11, Kreu II, të Ligjit nr.8450 datë 24.02.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës , të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, dhe germat a dhe b të pikë 1, të Kreut II, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 970, datë 02.12.2015.

**Argumentimi:**

*Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.*

*Legjislacioni në fuqi për prokurimin publik i jep mundësinë autoriteteve kontraktore që të kërkojnë licenca profesionale për furnizimin e mallrave objekt kontrate, të lëshuara nga autoritete kompetente shtetërore, në mënyrë që të vërtetojnë se malli, operatoti i plotëson kërkesat sipas të gjitha përcaktimeve të legjislacionit në fuqi, duke patur parasysht karakteristikat specifike të mallit.*

*Këto kritere janë vendosur që operatorët ekonomik të jenë të pajisur sipas ligjit me lejet dhe autorizimet përkatëse për tregtimin e këtij malli, në zbatim të Ligjit nr.8450 datë 24.02.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës , të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, dhe të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 970, datë 02.12.2015.*

*Kriteret e vendosur në referencë të dispozitave të sipërcituar, përcaktojnë se ofertuesit dhe rrjedhimisht fituesi i mundshëm, vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, dhe duhet të jetë i pajisur me licencat profesionale, të lëshuara nga autoritete kompetente shtetërore, që vërtetojnë pajtueshmërinë e ofertuesit me standardet e kërkuara në legjislacionin e sipërpërmendur. Pra konsiderohen si kritere të lidhura ngushtësisht me objektin e kontratës që prokurohet dhe i bazuar në LPP.*

2.3.3 .Autorizim të ushtrimit të aktivitetit (Tregtim me pakicë karburantesh) e lëshuar nga Njësia Vendore, sipas pikës 1, 2 dhe 3 të nenit 20, të Ligjit nr.8450 datë 24.02.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar.

**Argumentimi:**

*Këto kritere janë vendosur që operatorët ekonomik të jenë të pajisur sipas ligjit me lejet dhe autorizimet përkatëse për tregtimin e këtij malli, në zbatim të Ligjit nr.8450 datë 24.02.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës , të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, dhe të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 970, datë 02.12.2015.*

*Kriteret e vendosur në referencë të dispozitave të sipërcituar, përcaktojnë se ofertuesit dhe rrjedhimisht fituesi i mundshëm, vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, dhe duhet të jetë i pajisur me licencat profesionale, të lëshuara nga autoritete kompetente shtetërore, që vërtetojnë pajtueshmërinë e ofertuesit me standardet e kërkuara në legjislacionin e sipërpërmendur. Pra konsiderohen si kritere të lidhura ngushtësisht me objektin e kontratës që prokurohet dhe i bazuar në LPP.*

**2.3.3.**Subjekti ofertues duhet të ketë stacione të tregtimit me pakicë të karburantit brenda territorit të Bashkisë Korce, të vërtetuar me një nga format e disponimit sipas Kodit Civil (kontratë noteriale qeraje, akt pronësie ose te pasqyruara ne ekstraktin e QKB-se ). Stacionet e tregtimit me pakicë të karburanteve detyrimisht duhet të jetë i pajisur me Vërtetim teknik i lëshuar nga ISHTI ose Organet e Miratuara të Vlerësimit të Konformitetit (OMVK), për distributorët e shitjes me pakicë të cilat duhet të jenë brënda afatit të vlefshmërisë në datën e hapjes së ofertave.

**Argumentimi:**

*Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 8, të VKM nr.285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.*

*Në zbatim të dispozitave të sipërcituara gjykojmë se, kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, kapacitetet organizative, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës, autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.*

*Synimi i autoritetit kontraktor lidhet drejtpërdrejtë me verifikimin e përputhshmërisë së specifikimeve teknike të produkteve të ofruara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, me ato të kërkuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderi.*

*Sa më sipër, duke u nisur edhe nga natyra e mallrave të kërkuar, të cilët janë mallra me specifik të veçantë, gjykojmë se kriteret e kërkuara që operatorët ekonomik pjesëmarrës të paraqesin deklaratë se garanton furnizimin me karburant sipas standarteve shtetërore në fuqi S.SH.EN 590 : 2017 per Gazoil me tollona (bileta) të vlefshme në pika shitje karburanti (me shërbim 24 orë, çdo ditë të javës) dhe se operatori duhet të ketë stacione të tregtimit me pakicë të karburantit në adresat e përcaktuara, të vërtetuar me një nga format e disponimit sipas Kodit Civil, janë shumë të rëndësishme pasi aktiviteti i DPSHTRR shtrihet në të gjitha qarqet e Shqipërisë.*

*Ky kriter është vendosur për të bërë të mundur që Autoriteti Kontraktor të bëjë një vlerësim sa më të sakt të dokumentacionit lidhur me furnizimin objekt prokurimi.*

**2.3.5** Operoret ekonomikë pjesëmarrës duhet të jetë i pajisur me autobot te posaçëm për transport karburanti së bashku me aparatit matës.

2.3.5.1 Ne rastin kur O.E e ka ne pronesi duhet te paraqesë të:

- Lejë qarkullimi e vlefshme.
- Polica e sigurimit e vlefshme.
- Certifikatë për transport mallrash të rrezikshme, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor.
- Foto te mjetit dhe autobotit te posaçëm.

2.3.5.2 Kur mjete eshte me qira/ ose huaperdorje duhet te paraqese :

- Kontrate noteriale qeraje/huaperdorje objekt i ketij prokurimi dhe e vlefshme per periudhen e furnizimit.
- Lejë qarkullimi e vlefshme
- Polica e sigurimit e vlefshme
- Foto te mjetit dhe autobotit te posaçëm.
- Certifikatë për transport mallrash të rrezikshme, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor.
- ***Shënim:** Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor*

**Njesia e Prokurimeve**

**Olgerta Demiras**

**Vasjan Tona**

**Sonjela Zguri**